




"Intelektualet e rinj, Shprese"

# PROGRES RAPORT

DRAFT

## Transparenca në Bashkinë Shkodër



Zbatimi i ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit",

Shtator, 2017



## 1.Hyrje

Në muajin Prill 2016, Shoqata *“Intelektualët e rinj, Shpresë”* publikoj Raportin e parë mbi Transparencën në Bashkinë Shkodër i cili fokusohet në zbatimin e ligjit Nr. 119/2014, *“Për të drejtën e informimit”* si dhe në zhvillimin e procesit të konsultimit publik në zbatim të ligjit Nr. 146/2014, *“Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”*.

Ky raport prezanton në mënyrë të detajuar progresin e konstatuar në drejtim të rritjes së nivelit të transparencës në përgjithësi në Bashkinë Shkodër si dhe përmbushjen e atyre kritereve të detyrueshme të përcaktuara në mënyrë të detajuar në ligjin Nr. 119/2014, *“Për të drejtën e informimit”* si dhe të sanksionuara në parimin e transparencës në ligjin Nr. 139/2015, *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*

Gjatë gjithë periudhës Maj 2016 deri në Gusht 2017 shoqata *“Intelektualët e rinj, Shpresë”* ka vazhduar monitorimin e nivelit të transparencës në Bashkinë Shkodër, nëpërmjet vëzhgimit të website zrytarë të Bashkisë Shkodër si dhe nëpërmjet kërkesave për informim.

Gjatë publikimit të raportit të parë në Prill të vitit 2016, rezultoi se Bashkia Shkodër zbatonte jo në mënyrën e duhur rreth 50% të kritereve të përcaktuara në ligjin Nr. 119/2014, *“Për të drejtën e informimit”*. Gjatë monitorimit të progresit të arritur në lidhje me transparencën e Bashkisë Shkodër janë konstatuar hapa mjaft pozitivë në drejtim të rritjes së nivelit të transparencës ku faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër jep informacion brenda standarteve të ligjit Nr. 119/2014, *“Për të drejtën e informimit”* duke realizuar hapa konkretë dhe të prekshëm në zbatim të kritereve të përcaktuara në ligj dhe duke shënuar kështu një progres të dukshëm dhe të vlerësuar pozitivisht nga grupi i ekspertëve të cilët u angazhuan në hartimin e këtij progres raporti. Përdorimi i aplikacionit *“Transparenca e buxhetit”* si një gjetje inovatore ka shtuar mundësinë e qytetarëve, komunitetit, sektorit privat shoqërisë civile si dhe aktorëve të tjerë të monitorojnë zbatimin e buxhetit nga ana e Bashkisë Shkodër.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti synojnë që të inkurajojnë drejtuesit lokal në lidhje me rezultatet e arritura në drejtim të rritjes së nivelit të transparencës por edhe të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së transparencës duke ofruar informacionin për qytetarët në mënyrë sa më të thjeshtë dhe të kuptueshme duke ndikuar në rritjen e pjesmarrjes së qytetarëve në qeverisjen lokale si dhe në përmirësimin e cilësisë së qeverisjes dhe përmirësimit të shërbimeve të cilat ofrohen në nivel lokal.

*Ky raport u përgatit me iniciativën e shoqatës “Intelektualët e rinj, Shpresë”, në kuadër të projektit “Bëhu aktiv, ndërto të ardhmen!” me mbështetjen financiare të Olof Palme International Center në Shqipëri përmes financimit të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e Olof Palme International Center dhe Qeverisë Suedeze.*

©Copyright: Intelektualët e rinj, Shpresë  
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

## 2. Metodologjia

Hartimi i këtij raporti është bërë i mundur nëpërmjet komunikimeve zyrtare me Bashkinë Shkodër, kontakteve të drejtpërdrejta me drejtues dhe të zgjedhur vendorë, monitorimit të faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër [www.bashkiashkoder.gov.al/](http://www.bashkiashkoder.gov.al/).

Gjatë periudhës Maj 2016-Gusht 2017 gjithsej janë dërguar 20 kërkesa për informim pergjigja e të cilave ne çdo rast është dhënë brenda afatit ligjor.

Informacioni i grumbulluar i është nënshtruar ballafaqimit me dispozitat ligjore duke bërë më të lehtë arritjen e përfundimeve dhe rekomandimeve për përmirësimin e punës në drejtim të zbatimit të ligjmërisë dhe rritjes së transparencës. Raporti është fokusuar kryesisht në zbatimin e ligjit Nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe në ligjin Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendorë”

Rezultatet e monitorimit janë krahasuar me gjetjet e Raportit të parë mbi Transparencën në Bashkinë Shkodër të publikuar në muajin Prill 2016 duke bërë të mundur kështu edhe matjen e progresit të arritur në drejtim të rritjes së transparencës në Bashkinë Shkodër.


### 3. Progresi i transparencës sipas ligjit për të drejtën e informimit

Në pikën 1 të nenit 7 të ligjit Nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” përcaktohet se: “autoritetet publike duhet të vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik”. **Në këtë pikë rezulton të jetë bërë një progres krahasuar me Raportin e pare mbi Transparencen ne Bashkine Shkoder te publikuar ne muajin Prillit të vitit 2016 nga shoqata “Intelektualet e rinj, Shprese”**

Nga monitorimi i faqes zyrtare online rezulton se është publikuar vendimi nr.55 datë 20.03.2017 i Bashkisë Shkodër “Për miratimin e strukturës së administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër, për vitin 2017”.


Fig.1 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, “Organograma”

[www.bashkiashkoder.gov.al/show\\_image.php?file\\_id=1131](http://www.bashkiashkoder.gov.al/show_image.php?file_id=1131)



Në lidhje me përcaktimet e gërmës c, pika 1 të nenit 7 te ligjit Nr.119/2014, **“Për të drejtën e informimit”** ku duhet të jepet informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës, nga raporti **“ Mbi Transparencën në Bashkinë Shkodër”** i muajit Prill 2016 ky informacion nuk gjendej, ndërsa aktualisht rezultoi se **“formati kërkesë”** dhe **“formati ankesë”**, mund të shkarkohen menjëherë dhe lehtësisht nga të gjithë, duke shënuar kështu progres pozitiv!

Fig.2 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, **“Formati i kërkesave dhe ankesave dhe adresa për dërgim”**



Në lidhje me përcaktimet e gërmës ç, pika 1 të nenit 7 të ligjit Nr.119/2014, **“Për të drejtën e informimit”** ku duhet të jepet informacion me të dhënat për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinators për të drejtën e informimit, nga monitorimi rezultoi se një informacion i tillë është i paraqitur në mënyrë të plotë sipas përcaktimeve ligjore.

Fig.3 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, **“Koordinatori për të drejtën e informimit”**



Në lidhje me percaktimet e gërmës d, pika 1 të nenit 7 të ligjit Nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” ku duhet të jepet informacion përse i takon të dhënave për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime, nga raporti “Mbi Transparencën në Bashkinë Shkodër” i publikuar ne Prill te vitit 2016 rezultonte se një informacion i tillë nuk gjendej as për Kryetaren e Bashkisë.

Sipas monitorimit të bërë konstatohet një progress pjesërisht pozitiv ku vazhdojnë te mugojne dhe te jene te papublikuara të dhëna përse i përket arsimit, procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të Bashkise Shkoder!

Nga ana tjetër aktualisht në “Programin e Transparencës” janë publikuar pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, gjithashtu edhe strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë janë të paraqitura në vendimin nr.55 datë 20.03.2017 i Bashkisë Shkodër “Për miratimin e strukturës së administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër, për vitin 2017”.

Fig.4 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, “Zyrtaret qe mbartin detyrimin per deklarimin e pasurise”

Zyrtaret qe mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Institucioni	Funksioni	Lloji i deklarimit DPF/DPV/DP L
1	Voltana	Vehbi	Ademi	Bashkia Shkodër	Kryetar	DPV
2.	Teuta	Ramadan	Haxhi	Bashkia Shkodër	Drejtor Drejtoria dhe e Programimit Buxhetor	DPV
3.	Marçelina	Çesk	Gjeluci	Bashkia Shkodër	Drejtor Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve	DPV
4.	Ridvan	Ramadan	Sokoli	Bashkia Shkodër	Drejtor Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Kilmës së Biznesit	DPV
5.	Ardita	Xhevdet	Peraj	Bashkia Shkodër	Drejtor Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	DPV
6.	Aida	Thanas	Shllaku	Bashkia Shkodër	Drejtor Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave	DPV
7.	Blendi	Skender	Gjylbegaj	Bashkia Shkodër	Drejtor Drejtoria e Planifikimit dhe regjistrimit te te Ardhurave	DPV
8.	Alfred	Gjergj	Luleta	Bashkia Shkodër	Drejtor Drejtoria e Shërbimit dhe Infrastrukturës	DPV
9.	Alban	Beqir	Sekja	Bashkia Shkodër	Drejtor Drejtoria e Bujqesise, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP	DPV
10.	Aljon	Reshat	Koçkiçi	Bashkia Shkodër	Drejtor Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve	DPV
11.	Blerta	Shuajb	Mjeda	Bashkia Shkodër	Drejtor e Finances	DPV
12.	Filip	Gjon	Vila	Bashkia Shkodër	Drejtor Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit	DPV
13.	Gentian	Myzafer	Mema	Bashkia Shkodër	Drejtor e turizmit	DPV
14.	Kreshnik	Behadir	Kopliku	Bashkia Shkodër	Drejtor Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit	DPV
15.	Terezina	Kolë	Hila	Bashkia Shkodër	Drejtor Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	DPV
16.	Shkelzen	Baki	Mustafaraj	Bashkia Shkodër	Drejtoria për Ndhmën Ekonomike dhe Personat me Atësi Ndryshe	DPV

Fig.5 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, “Struktura organizative Bashkia Shkoder”

STRUKTURA ORGANIZATIVE BASHKIA SHKODER			Tabela I			
Emërtimi	Punonjës	I zgjedhur, I emruar	Arsimi i lartë		Arsimi i mesëm	
			Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga baze mujore
Kryetar	1	140,000				
Zv. Kryetar	4					
Zv. Kryetar	4	100,000				
<b>Këshilli Bashkiak</b>	<b>1</b>					
Sekretar i Këshillit Bashkiak	1		II- b	63,000		
<b>Administratore</b>	<b>10</b>					
Pult	1	50,000				
Shosh	1	50,000				
Shalë	1	50,000				
Postribë	1	72,000				
Guri i Zi	1	72,000				
Bërdicë	1	70,000				
Velipojë	1	79,500				
Dajç	1	70,000				
Ana e Malit	1	68,000				
Rrethina	1	80,000				
<b>KABINETI</b>	<b>9</b>					
Këshilltar kryetari	6		III - a/1	55,000		
Sekretar i Kryetarit	1		IV-b	26,000		
Punonjes sekretarie	2				VII	28,400
<b>Komunikimi me median</b>	<b>3</b>					
Fotoreporter	3				VIII	29,200
<b>Njësia e prokurimit</b>	<b>4</b>					
Përgjegjës	1		III-a	42,000		
Specialist	2		III-b	38,000		
Specialist	1		III-b	35,000		
<b>Njësia e auditit</b>	<b>3</b>					
Përgjegjës njësia e auditit	1		III-a	45,000		
Specialist	1		III-b	36,000		

Përsa i përket Kryetares së Bashkisë Shkodër tashmë janë publikuar të dhëna mbi arsimin, kualifikimet dhe karrierën e saj.

Fig.6 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, “Kryetari i Bashkisë”

The screenshot shows the official website of the Municipality of Shkodër. The header includes the logo and name of the municipality, along with navigation links for 'Kreu', 'Bashkia', 'Keshilli Bashkiak', 'Programi i Transparencës', 'Keshillim me Publiken', 'Shpallje/Njoftime', and 'English'. Below the header, there are several menu items: 'Rreth Shkodrës', 'Vizitori', 'Per Biznesin', 'Për Qytetarët', and a search bar. The main content area is titled 'Kryetari i Bashkisë' and features a profile of Voltana Ademi. The profile includes a brief biography, her educational background, her professional experience, and her role as Mayor. It also mentions her involvement in various community and political activities.



*Përsa i përket procedurës që këta funksionarë ndjekin për të marrë vendime, ka vetëm disa vendime për delegim të kompetencave tek zv/kryetarët, por duke qënë se këto akte janë të përkohëshme dhe me funksione deleguese nuk mund të kuptohet qartë se cilët janë funksionet permanente të tyre!*

Në lidhje me përcaktimet e gërmës dh, pika 1 të nenit 7 të ligjit Nr.119/2014, “***Për të drejtën e informimit***” ku duhet të jepet informacion mbi mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit, rezultojnë se janë publikuar raporte të auditit , të cilët **përbëjnë një progres pozitiv në lidhje me raportin e mëparshëm!**

*Po ashtu përsa i përket planeve ekzistuese strategjike nuk janë të rifreskuara si dhe mungojnë dokumentet që përmbajnë treguesit e performancës së autoritetit publik!*

**Fig.7 Faqja zyrtare Bashkia Shkodër, “Planet strategjike”**



Në lidhje me përcaktimet e gërmës e, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifatat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara, ***në lidhje me këtë pikë, informacioni i dhënë në lidhje me buxhetin është dhënë i plotë qoftë për vitet e mëparshme, ashtu edhe për buxhetin e vitit 2017 ku është publikuar edhe plani buxhetor afatmesëm 2018-2019.***

Fig.8 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, “Buxheti”

Informacioni në lidhje me tarifat e taksave dhe të liçensave në rubriken “Taksat dhe Tarifat” nuk gjendet, por një informacion i tillë mund të gjendet në rubrikën “Paketa Fiskale” për vitin 2017.

Fig.9 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, “Taksat dhe tarifat”

Në lidhje me percaktimet e gërmës ë, pika 1 të nenit 7 të ligjit Nr.119/2014, **“Për të drejtën e informimit”** ku duhet të jepet informacion mbi procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, **“Për prokurimin publik”**, dhe të ligjit nr. 125/2013, **“Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”**, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:


- i) listën e kontratave të lidhura;
- ii) shumën e kontraktuar;
- iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
- iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave,
- v) si dhe udhëzues e politika të ndryshme,

**Nga monitorimi i kryer rezulton progres pozitiv** ku ofrohet informacion mbi procedurat e prokurimit, shumat e kontraktuara, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara. Përsa mësipër në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër është publikuar shkresa nr.2495 Prot të Bashkisë Shkodër, datë 22.02.2017, Lënda: **“Për miratim regjistri të parashikimeve të prokurimeve publike për Bashkinë Shkodër viti 2017”** është publikuar Regjistri i Prokurimeve Publike.

Po ashtu në faqen zyrtare të Bashkisë **“Transparenca e Buxhetit”** të dhëna për realizimin e buxhetit jepen nëpërmjet një aplikacioni, i cili është lehtësisht i aksesueshëm nga çdo qytetar ku gjinden informacione sipas zërave të buxhetit.


**Fig.10 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, “Regjistri i Prokurimeve Publike”**

www.bashkiashkoder.gov.al/web/regjistri\_i\_parashikimeve\_publike\_2017\_1061.pdf



Regjistri i Parashikimeve Publike  
Autoriteti Kontraktor: BASHKIA SHKODER Nr.Ref.2141-001

Nr.	Objekti i prokurimeve	Fondi limit i përgjithshëm		Burimi i financimit	Lloji i procedurës së prokurimit	Koha e planifikuar për zhvillimin e procedurës
		Investime	Shpenzime			
1	Blerje materiale kancelarie		8,368,058	Buxheti i Bashkisë	Procedurë e Hapur (Blerje e përqëndruar)	Gjatë vitit
2	Blerje materiale pastrimi		83,333	Buxheti i Bashkisë	Kërkesë për propozime (Blerje e përqëndruar)	Gjatë vitit
3	Blerje dokumentacione (shtypshkrime)		666,666	Buxheti i Bashkisë	Blerje me vlerë të vogël	Gjatë vitit
4	Blerje uniforma		500,000	Buxheti i Bashkisë	Blerje me vlerë të vogël	Gjatë vitit
5	Materiale të tjera (bojra, stuko etj)		166,666	Buxheti i Bashkisë	Blerje me vlerë të vogël	Gjatë vitit
6	Materiale hidraulike		83,333	Buxheti i Bashkisë	Blerje me vlerë të vogël	Gjatë vitit
7	Blerje gaz të lëngshëm		500,000	Buxheti i Bashkisë	Kërkesë për Propozime (Blerje e përqëndruar)	Gjatë vitit
8	Shërbime telefonice celulare		100,000	Buxheti i Bashkisë	Blerje me vlerë të vogël	Gjatë vitit
9	Larje tapeta, automjete e shërbime të tjera		37,500	Buxheti i Bashkisë	Blerje me vlerë të vogël	Gjatë vitit
10	Abonim satelitor		35,000	Buxheti i Bashkisë	Blerje me vlerë të vogël	Gjatë vitit
11	Shpenzime të tjera (buqeta, kurora, lule)		116,666	Buxheti i Bashkisë	Blerje me vlerë të vogël	Gjatë vitit
12	Rimbushje fikese zjarri		263,333	Buxheti i Bashkisë	Kërkesë për Propozime (Blerje e përqëndruar)	Gjatë vitit
13	Blerje fshëkzjarre		291,666	Buxheti i Bashkisë	Blerje me vlerë të vogël	Gjatë vitit
14	Blerje karburant		2,101,600	Buxheti i Bashkisë	Procedurë e Hapur (Blerje e përqëndruar)	Gjatë vitit
15	Blerje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje për automjetet e Bashkisë Shkodër		2,531,665	Buxheti i Bashkisë	Kërkesë për propozime	Gjatë vitit
16	Siguracion për automjetet e Bashkisë Shkodër		426,000	Buxheti i Bashkisë	Blerje me vlerë të vogël	Gjatë vitit



Në lidhje me përcaktimet e gërmës f, pika 1 të nenit 7 të ligjit Nr.119/2014, **“Për të drejtën e informimit”** ku duhet të jepet informacion mbi shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, **në faqen zyrtare të Bashkisë gjendet informacion i mjaftueshëm i vlefshëm për publikun, si p.sh dokumentacioni që duhet të plotësojnë në lidhje me aplikime/kërkesa të ndryshme, gjë që konsiderohet mjaft pozitive.**

**Fig.11 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, “Dokumente për shkarkim”**

The screenshot displays the official website of the Municipality of Shkodër. At the top, there is a navigation bar with the following items: 'Kreu', 'Bashkia', 'Këshilli Bashkiak', 'Programi i Transparencës', 'Këshillim me Publikun', 'Shpalje/Njoftime', and 'English'. Below this, there are four main navigation categories: 'Rreth Shkodrës', 'Vizitori', 'Për Biznesin', and 'Për Qytetarët'. A search bar is located on the right side of the navigation bar. The main content area is titled 'Dokumenta për shkarkim' and contains several document cards, each with a document icon and a title. On the left side, there is a sidebar menu with various categories such as 'Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit', 'E drejta për informim', 'Mjedisi, Pyjet dhe Ujërat', 'Mobiliteti urban', 'Shpalje Kërkesë për Leje Zhvillimi', 'Arsimi shkollat', 'Strehimi dhe ndërtesat', 'Siguria dhe rendi', 'Emergjencat', 'Politikat dhe shërbimet sociale', 'Trajnime programe', 'Efiçenca e energjisë', 'Dokumenta për shkarkim', 'Rekorde arkiva foto', and 'Legjislacion udhëzues'.

Në lidhje me përcaktimet e gërmës g, pika 1 të nenit 7 të ligjit *ku duhet të jepet informacion mbi çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, nga monitorimi rezulton të jetë publikuar procedura për bërjen e ankesave në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik.*

**Fig.11 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, “Procedurat e kërkesave dhe ankesave”**

Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat ankimit të vendimit përkatës.	Ligi nr.119/2014 Neni 7/1/c/g	Strategjia Territoriale e Shkodrës Plani i Zhvillimit të Territorit	Pas miratimit të Programit të Transparencës	Në faqen zyrtare në menushë Formular Online E drejta për Informim	Zyra me Një Ndalesë
		<p>Regullore e ofrimit të Shërbimeve Administrative të Bashkisë Shkodër</p> <p>Format Ankesë</p> <p>Formati i Kërkesës për Informacion</p> <p>Në ambientet e Zyrës me Një Ndalesë Shpjeguese:</p> <p>Adresë postare: Bashkia Shkodër, rr.13 dhjetori, nr.1 Adresë e-mail: mpubliku@bashkiashkodër.gov.al</p>			

Në lidhje me përcaktimet e gërmës gj, pika 1 të nenit 7 të ligjit *ku duhet të jepet informacion mbi çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; Nga monitorimi rezulton se Bashkia Shkodër në faqen zyrtare të saj ka çelur një rubrikë të veçantë “Këshillim me Publikun” ku personat e interesuar mund të shprehin mendimin e tyre rreth politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik. Në një raport të më vonshëm do prezantohen në mënyrë më të detajuar gjetjet nga monitorimi i ligjit “ Për njoftimin dhe konsultimin publik”.*

**Fig.12 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, “Këshillim me Publikun”**

Këshillim me Publikun	Rezultate 1 - 5 / 5	Mundësi Punësimi
<p>23.09.2017 Miratimi i kalendrit të përgatitjes së projektit programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe projektit buxhetor vjetor 2018. Në mbledhjen të ligjit nr. 139/2015 të miratuar me datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji nr. 9936 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar...</p> <p>Shtyp: Bashkia Shkodër</p> <p>Më shumë</p>		
<p>23.09.2017 Njoftim për Këshillim me Publikun për projektin aktin "Për rihapërdorje fondesh të Bashkisë Shkodër". Në mbledhjen dhe zbatim të nenit 18 dhe nenit 54 shkronja "b" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Këshilli Bashkiar Shkodër rrajon zhvillimin e seancës së këshillimit me publikun për diskutimin e projektit aktin...</p> <p>Shtyp: Bashkia Shkodër</p> <p>Më shumë</p>		
<p>20.08.2017 Ftesë për diskutim në shprehim publikë që organizohet nga Bashkia Shkodër në projektin të projektit "Konsultimi i brengët pararendësor të Ligjeve të...</p>		

Në lidhje me percaktimet e gërmës h, pika 1 të nenit 7 të ligjit Nr.119/2014, **“Për të drejtën e informimit”** ku duhet të jepet informacion mbi sistemin që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; nga monitorimi rezulton se ky informacion është përfshirë në Programin e Transparencës.

Fig.13 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, “Mbajtja e dokumentacionit”

**Lista tip e dokumenteve me afatet e ruajtjes**

Nr	EMERTIMI	AFATI I RUAJTJES
1	Dokumente për krijimin, organizimin, riorganizimin dhe funksionimin e autoritetit publik <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendime</li> <li>• Skema organizative</li> <li>• Rregullore</li> </ul>	Ruhen përgjithmonë
2	Dokumente të hartuara dhe miratuara nga bashkia <ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzime</li> <li>• Vendime</li> <li>• Urdhra</li> <li>• Aurtorizime</li> <li>• Udhezues</li> </ul>	Ruhen përgjithmonë
3	Dokumente të veprimtarisë së punës së autoritetit publik <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lige</li> <li>• Plane</li> <li>• Strategji</li> <li>• Raporte</li> <li>• Rezoluta</li> <li>• Marreveshje</li> </ul>	Ruhen përgjithmonë
4	Dokumente mbi kontrollin e veprimtarisë së kontrolluesve publik dhe privat <ul style="list-style-type: none"> <li>• Urdhra</li> <li>• Procesverbale</li> <li>• Relaçione</li> <li>• Rekomandime</li> <li>• Vendime</li> </ul>	Ruhen përgjithmonë
5	Korrespondencë e thjeshtë me kontrollues publik dhe privat dhe subjekte të të dhënave	Ruhen 5-10 vjet
6	Dokumente të kontrolluesve publik dhe privat mbi njoftim-regjistrimin	Ruhen përgjithmonë

Në lidhje me percaktimet e gërmës i, pika 1 të nenit 7 të ligjit Nr.119/2014, **“Për të drejtën e informimit”** ku duhet të jepet informacion mbi regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji; nga monitorimi rezulton se rregjistri i kërkesave dhe përgjigjeve tashmë është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe është i rifreskuar.

Fig.13 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

www.bashkiashkoder.gov.al/web/Regjistri\_i\_Kerkesave\_dhe\_Pergjigjeve\_555\_1.php

Kreu Bashkia Këshilli Bashkiak Programi i Transparencës Këshillim me Publikun Shpallje/Njoftime

**Bashkia Shkodër**

Rreth Shkodrës Vizitori Për Biznesin Për Qytetarët Kërko

**Programi i Transparencës**

Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve

Koordinatori për të Drejtën e Informimit

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Statusi i kërkesës	Tarifa
01	05.01.2017	Informacion për planin urbanistik për zonën në të cilën banoj	17.01.2017 Nr.622 prot Parcela kategorizohet A2, rezidenciale me dendësi të mesme	Përfunduar	Nuk ka
02	11.01.2017 Nr.181 praktike	Informacion për punime të kategorisë, riparime.	13.01.2017 Bazuar në ligj nr.107/2014 dhe VKM-se 408, date 13.5.2015 duhet të saktësoni flojet e punimeve që do të kryeni në pronë.	Përfunduar	Nuk ka

Print Email

Në lidhje me përcaktimet e gërmës j, pika 1 të nenit 7 të ligjit Nr.119/2014, **“Për të drejtën e informimit”** ku duhet të jepet informacion mbi kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato; nga monitorimi rezulton se në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër është përfshirë informacion në lidhje me format e ndihmës shoqërore si dhe procedurave për të përfituar.

**Fig.14 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, Shërbimi i Ndhmës Ekonomike**

www.bashkiashkoder.gov.al/web/Sherbimi\_i\_Ndihmes\_Ekonomike\_322\_1.php

**Bashkia Shkodër**

Kreu | Bashkia | Këshilli Bashkiak | Programi i Transparencës | Këshillim me Publikun | Shpallje/Njoftime

Rreth Shkodrës  
Qyteti shtrihet në brigjet e liqenit me të njetin

Vizitori

Për Biznesin  
Biznesi i vogël konsiderohet motor i

Për Qytetarët

Kërko  
Kërko

Print | Email

**Për Qytetarët**

- Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit
- E drejta për Informim**
  - Mbrojtja e të dhënave personale
  - Moduli i Kërkesave
  - Shërbimi i Ndhmës Ekonomike**
  - Shërbimi i Gjendjes Civile

**Shërbimi i Ndhmës Ekonomike**

Për përfitimin e ndihmës ekonomike, të kujdestarisë, të invaliditetit të punës, të personave me aftësi të kufizuar, para dhe tetraplegjik dhe të verbër duhet të dorëzojnë pranë drejtorisë së ndihmës ekonomike këto dokumenta:

Ndihma ekonomike u jepet familjeve të shtetasve shqiptarë, të cilëve u mungojnë të ardhurat dhe mjetet e jetesës krejtësisht, ose i kanë të pamjaftueshme. Shteti merr në mbrojtje dhe personat me aftësi të kufizuar, të verbërit, invalidët e punës dhe invalidët tetraplegjikë dhe paraplegjikë.

- Ndihma ekonomike**
- Invaliditeti i punës**
- Personat me aftësi ndryshe**

## IV. Përfundime dhe rekomandime

Nga monitorimi i detyrimeve që rrjedhin prej legjislacionit në fuqi në lidhje me të drejtën e informimit dhe transparencën e institucioneve vendore, rezulton se në Bashkinë Shkodër janë bërë hapa pozitivë dhe ato reflektohen në vazhdimësi për efekt të respektimit të tyre, çka tregon për angazhim dhe përgjegjshmëri të këtyre zyrtarëve vendorë. Pavarësisht përmirësimeve në këtë drejtim, duhet theksuar se ende ka vend për të përmirësuar në respektimin e detyrimeve që u vendosen autoriteteve vendore për garantimin e së drejtës për informim.

Ky progres raport evidenton progresin e dukshëm pozitiv në drejtim të rritjes së transparencës në Bashkinë Shkodër siç u përmend në mënyrë më të detajuar më sipër. Për të patur një vazhdimësi në ruajtjen dhe ngritjen e nivelit të transparencës rekomandohet si mëposhtë:

- *Praktika e mirë dhe progresi pozitiv i Bashkisë Shkodër në rritjen e transparencës së veprimtarisë së saj duhet që të pasohet tek njësitë administrative dhe sidomos tek shoqëritë publike të cilat janë nën varësinë e Bashkisë Shkodër*
- *Duke qënë se jo të gjithë janë të familjarizuar me përdorimin e faqes zyrtare dhe të aksesimit të informacionit që ajo përmban, apo edhe dinë ta përdorin; Qytetarët preferojnë të drejtohen direkt pranë zyrtarëve të institucioneve vendore, pasi hasin vështirësi dhe pengesa burokratike për hartimin e kërkesave për informacion ose e kanë më të thjeshtë për të marrë informacion të drejtëpërdrejtë prandaj është e rëndësishme shtimi i sporteve të informacionit dhe shërbimit në edhe në njësitë administrative të Bashkisë Shkodër.*
- *Mekanizmat dhe procedurat për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, si dhe për çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyrë tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik duhet të jenë me të qarta për qytetarët dhe grupet e interesit.*
- *Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve mbi dispozitat ligjore që u garantojnë marrjen e informacionit edhe procedurat që duhet të ndjekin për realizimin e kësaj të drejte duhet të realizohet edhe nepermjet takimeve publike në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër*



- *Informimi i vazhdueshëm i punonjësve të administratës dhe monitorimi i sjelljes së tyre, për sa lidhet me ndjekjen e procedurave dhe respektimin e afateve ligjore për dhënien e informacionit;*
- *Nxitja e profesionalizmit për të përmirësuar cilësinë dhe formën e dhënies së informacionit për qytetarët nepermjet forcimit te kapaciteteve të administratës për të përmbushur më së miri detyrimet me të cilat i ngarkon ligji për të drejtën e informimit;*
- *Përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare në lidhje me informacionin e dhënë dhe programin e transparencës nga ana e Bashkise, si pjesë e detyrimit ligjor që ka.*
- *Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe projekte apo aktivitete të përbashkëta duke nxitur mekanizmat monitorues të transparencës;*
- *Duhet të krijohen forma të ndryshme të pjesmarrjes së qytetareve online nëpërmjet blog/diskutime online apo zhvillimin e aplikacioneve mobile.*